

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Buxheti arkëtoi 18 milionë euro më shumë në mars-korrik, vetëm nga shtrenjtimi i naftës dhe benzinës
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/buxheti-arketoi-18-milione-euro-me-shume-ne-mars-korrik-vetem-nga-sht-i103370
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 06:21:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 06:14:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6839257176f5a4093ce31e3a4ebfad2ad65e810f30de77c53a9e64c7fb8ab421
TEKSTI	6206e1c6737edb141065083e85b0ff7255f18971aaaaac9c6f603300c99888b6
PAMJA	12eb55cab7d4f892816db20742877268fe03c72d071c95170a5886fb065aae3b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	32b9da150f36bca09b16fa62c8797e06635219a75a945941aaaaa45ec06ae0ec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37e88de21e6052c43008725ce34c5b1787df35e11e0ce0b49f71d19634f38dd3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/32b9da150f36bca09b16fa62c8797e06635219a75a945941aaaaa45ec06ae0ec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

dollari dhe euro,

rethoçet me 78.6 lekë, në shitje me

Kryeministrisë: Rama jep

ndërsa shënojnë ditën

vranësira, si do të jenë

meteorologjik. Moti parashikohet

filipinasit dhe

gjinje e më të theksuar të turisë

e reja në dashuri,

vetëm që te ruani një ambient sa më të

AKTUALITET

Buxheti arkëtoi 18 milionë euro më shumë në mars-korrik, vetëm nga shtrenjtimi i naftës dhe benzinës

Piranjat Përditësimi i fundit 10 Shtator 2026, 08:14



Rritja e çmimit të karburanteve që nga fillimi i muajit mars, pas përshkallëzimit të konflikteve në Lindjen e Mesme, ka gërryer të ardhurat e përdoruesve të mjeteve, operatorëve të transportit publik dhe me efekt zinxhir, të gjithë të tjerëve që u janë shtuar kostot nga transporti.

Sot, një litër naftë kushton 219 lekë dhe benzina 205 lekë, nga 175 që ishin çmimet deri në mars. Më i fituari rezulton që të ketë dalë buxheti, që ka arkëtuar më shumë të ardhura nga shtrenjtimi i naftës, përmes tatimit mbi vlerën e shtuar prej 20%, i cili i ngarkohet konsumatorit duke u shtuar në çmimin final të pakicës.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Doganave, të përpunuara nga Monitor, nga muaji mars, kur filloi rritja e çmimeve, deri në korrik, buxheti ka arkëtuar nga importi i naftës dhe benzinës, përmes taksës doganore, akcizës dhe TVSH-së, rreth 20.2 miliardë lekë, me një rritje prej 9.1% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ose gati 1.7 miliardë lekë më shumë (rreth 18 milionë euro).

Për të njëjtën periudhë, importi ishte 387 milionë litra, ose 0.6% më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë, një tregues që rritja e të ardhurave është tërësisht efekti i shtrenjimit të çmimeve. Gati 80% e importit është nga nafta dhe pjesa tjetër benzinë.

Në dy muajt e parë të vitit, një litër naftë u zhdoganua me rreth 50 lekë për litër. Çmimi kërceu në mars në 81.4 lekë dhe kulmoi në prill në 99 lekë.

Pas një rënieje të përkohshme në prill, korriku solli sërish shtrenjtim në 83 lekë. E gjithë diferenca e çmimit u transmetuar në më shumë të ardhura nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Edhe benzina u shtrenjtua deri në 74 lekë për litër në maj, nga 45 lekë në shkurt. (shiko grafiket: Vlera për litër e naftës dhe benzinës së importit).

Ndonëse ka arkëtuar rreth 18 milionë euro më shumë të ardhura vetëm nga shtrenjtimi i naftës, qeveria shqiptare, që e taton naftën më shumë se çdo vend tjetër në Ballkan, nuk ia ka kthyer një pjesë mbrapsht qytetarëve përmes lehtësive fiskale, ndryshe nga vendet e tjera të rajonit.

Për shkak të barrës së lartë fiskale, nafta në Shqipëri kushton 41% më e shtrenjtë se në Maqedoninë e veriut, që është më e lira në rajon dhe 17% më shumë se në Serbi, i dyti më i shtrenjti në rajon pas nesh. Nafta në Shqipëri është 30% më e shtrenjtë se mesatarja e rajonit prej 1.77 lekë për litër, sipas përlogritjeve të "Monitor".

Nëse për të gjitha vendet e rajonit zbatohet një strukturë e thjeshtë për llogaritjen e çmimit të naftës (çmimi bazë + akcizë dhe mbi këtë shumë llogaritet TVSH-ja), në Shqipëri përveç akcizës 0.37 euro për litër dhe TVSH-së 20%, mbi çmimin e naftës aplikohet edhe dy taksa të tjera shtesë, taksa e qarkullimit (27 lekë për litër) dhe taksa e karbonit (3 lekë për litër).

Kjo bën që struktura fiskale në Shqipëri të jetë dukshëm më e rënduar, duke përbërë rreth 50% të çmimit apo 100 lekë për litër.

Ndryshe nga vendet e tjera të rajonit, që kanë zbatuar lehtësi të shumta fiskale, ndërhyrjet e qeverisë shqiptare kanë qenë minimale.

Në muajt mars u miratua vendimi për uljen e akcizës të karburantet me 20% nëse çmimi i naftës kalonte vlerën e 220 lekëve për litër me pakicë dhe për benzinën masa zbatohet nëse çmimi kalon 200 lekë për litër. Sipas burimeve zyrtare, masa është përdorur 2 herë dhe efekti financiar llogaritet 37 mln lekë apo rreth 400 mijë euro.

Mars-korrik, shqiptarët shpenzuan 60 milione euro më shumë për të bërë naftë, për konsum të njëjte

Ndryshe nga qeveria, që ka mbledhur më shumë të ardhura, konsumatorët kanë pasur një barrë të rëndë financiare për shpenzimet për karburant.

Të dhënat e importeve për periudhën mars-korrik 2026 tregojnë se në pesë muaj u importuan rreth 305.8 mijë tonë karburante, vetëm 1.2% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur sasia ishte rreth 309.6 mijë tonë.

“Monitor” ka përllogaritur më herët se, duke supozuar që karburantet e importuara kanë kaluar për konsum në tregun vendas, për sasi të importuara nga marsi deri në korrik janë shpenzuar rreth 71.3 miliardë lekë, bazuar në çmimin mesatar mujor të naftës në tregun vendas.

Për të njëjtën sasi karburanti, nëse çmimi do të kishte mbetur në nivelin mesatar të vitit të kaluar prej rreth 175 lekësh për litër, fatura do të ishte rreth 63.7 miliardë lekë.

Diferenca arrin në rreth 7.6 miliardë lekë, ose afërsisht 80 milionë euro më shumë, të paguara vetëm si pasojë e çmimit më të lartë të karburantit. Gati një e katërta e kësaj shume ka shkuar në buxhetin e shtetit, përmes pagesave të rritura për TVSH-në./Monitor.al

TË ARDHURAT DOGANORE NGA IMPORTI I NAFTËS DHE BENZINËS, MLN LEKË (TAKSË DOGANORE, + AKCIZË + TVSH)



Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 10 Shtator08:04

[Këmbimi valutor/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera](#)

Ditën e some dollari amerikan në blerje do të këmbehet me 78.6 lekë, në shitje me 79.6 lekë. Euro do të blihet me 91...

AKTUALITET 10 Shtator07:27

[Kur lufta kërcënonte jetën e natës në Tiranë: ankesa për balerinat që tronditi lokalet e kryeqytetit në vitin 1942](#)

Lufta e Dytë Botërore nuk ndryshoi vetëm kufijtë dhe fatet politike të vendeve. Ajo ndërhyri edhe në jetën e përd...

AKTUALITET 10 Shtator07:21

[Moti parashikohet me kthjellime dhe vranësira, si do të jenë temperaturat](#)

Edhe për ditën e enjte, vendi ynë do të vijojë të ndikohet nga e njëjta situatë meteorologjik. Moti parashikohet me k...

AKTUALITET 10 Shtator07:15

[Programi me BB, raporti: Probleme te ndërmarrjet shtetërore, Fondi Social dhe menaxhimi i mbetjeve](#)

Pavarësisht një rezultati në total pozitiv, disa objektiva të Programit të Dytë të Politikave për Qëndrueshmë...

AKTUALITET 9 Shtator22:42

[Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto: Rama në burg](#)

Protestuesit po vijojnë revolën e tyre në kryeqytet, ndërsa këtë herë kanë shkuar tek Vasil Shanto. Ata kanë t...

AKTUALITET 9 Shtator22:24

[Velipojë/ Pamje me armë zjarri në një lokal, avokati: Në dosje përmenden edhe punonjës policie](#)

Një video e publikuar nga avokati Arben Llangozi në Facebook rikthen në vëmendje një ngjarje të ndodhur në Gomsinë e R...

AKTUALITET 9 Shtator21:59

[Shkodër/ Kontrollë të shtuara të policisë pas ngjarjeve kriminale](#)

Pas ngjarjeve të fundit kriminale, Policia e Shkodrës ka shtuar kontrollët në pika të ndryshme të qytetit. Një postbllok policie ...

AKTUALITET 9 Shtator21:38

[FOTO-LAJM/ Skenari i ri i protestës, qytetarët bllokojnë disa rrugë në Tiranë](#)

Pas përfundimit të fjalimeve para Kryeministrit, protestuesit kanë ndryshuar skenarin e protestës, duke nisur marshimin në bule...

AKTUALITET 9 Shtator21:30

[VIDEO/ Disa protestues bllokojnë kryqëzimin te “Rruga e Elbasanit”, rëndohet trafiku në Tiranë](#)

Një pjesë protestuesish kanë përshkallëzuar aksionin e tyre në Tiranë, duke bllokuar qarkullimin në kryqëzimin pran...

AKTUALITET 9 Shtator21:17

[Elbasanliu dhe gjirokastriti “kapen mat” në kufi, tentuan të fusnin kontrabandë qindra kilogramë mish dhe peshk nga Athina](#)

Strukturat e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastër kanë goditur këtë të mërkurë dy raste të...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 9 Shtator

[Kush qëllon i pari? Ekspertiza zbulon të vërtetën...](#)

Dyshohet se ka qenë Valentina Pambianco ajo që ka marrë armën dhe ka tërhequr këmbëzën, duke vrarë bashkësho...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 9 Shtator

[Futën Ziza Pajazitin në burg/ Polici merret i p...](#)

Perent Lëngu, një punonjës me karrierë 18 vjeçare në burgun e Drenovës të Korçës, është marrë...

AKTUALITET 9 Shtator

[Zbardhen dy vjedhje në Korçë, arrestohet 18-vje...](#)


Policia e Korçës ka zbardhur dy raste vjedhjeje të ndodhura në qytet dhe ka arrestuar një prej autorëve të dyshuar, ndë...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video






Reagon Clevio!



Reagon Clevio!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.